



ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË KOSOVË¹
DEKLARATË PRELIMINARE

Dita e suksesshme e zgjedhjeve konsolidon progresin e demokracisë në Kosovë

Prishtinë, 9 qershor 2014

Përmbledhje

- Zgjedhjet e parakohshme të 8 qershorit 2014 ishin transparente dhe të organizuara mirë dhe konsoliduan progresin e bërë në zgjedhjet komunale të vitit 2013. Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe gjithëpërfshirëse dhe kaloi pa ndonjë incident të madh derisa njerëzit votuan gjithandej Kosovës, përfshirë edhe në veri. Garuesit bënë fushatë lirshëm dhe u përmbajtën nga gjuha nxitëse. Korniza e shkurtër kohore e zgjedhjeve të parakohshme, megjithatë, pati ndikim negativ në aspekte të ndryshme të procesit.
- Procedura e hapjes, votimit, mbylljes dhe numërimit në ditën e zgjedhjeve, të gjitha, u vlerësuan pozitivisht nga vëzhguesit e EU EOM-it. Qytetarët e shprehën të drejtën e tyre demokratike për të votuar, përfshirë edhe në veri. Janë raportuar disa raste të izoluar të praktikave të palejueshme, të cilat u adresuan nga autoritetet përkatëse.
- Korniza ligjore që ka rregulluar zgjedhjet e kaluara parlamentare dhe lokale mbetet në fuqi në këto zgjedhje. Përkundër një numri përpjekjesh për reformimin e sistemit zgjedhor në Kosovë, të metat e identifikuara gjatë dy proceseve të kaluara zgjedhore nuk ishin adresuar. Megjithatë, legjislacioni ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në pajtim me dokumentet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në kushtetutën e saj.
- Vendimi për të shpallur zgjedhjet e parakohshme për datën më të hershme të mundshme pas shpërndarjes së Kuvendit, ndonëse është e ligjshme, pati ndikim në disa aspekte të procesit zgjedhor. Kjo paraqiti sfida shtesë për organizimin me kohë të zgjedhjeve dhe për afatet ligjore për parashtrëse dhe ankesa para ditës së zgjedhjeve. Kjo po ashtu e shkurtoi fushatën zyrtare në dhjetë ditë.
- Të gjitha nivelet e administrimit të zgjedhjeve e kryen punën e tyre në mënyrë transparente. Përkundër periudhës së shkurtër kohore, administrata e zgjedhjeve i ka organizuar mirë zgjedhjet në nivelin teknik, duke përmbushur shumicën e afateve të saj operacionale, përfshirë edhe trajnimin e KVV-ve, shtypjen e manualeve dhe

¹ Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999) dhe mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës
Ky raport preliminar është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe por vetëm versioni anglisht është zyrtar.

fletëvotimeve, dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore. Megjithatë, disa nga vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nuk e rritën besimin e publikut në punën e tij.

- Në pjesën më të madhe të Kosovës fushata ishte dinamike. Garuesit patën mundësi të bënin fushatë lirshëm dhe fushata u intensifikua në ditët e fundit të saj. Kandidatët u fokusuan më shumë në çështje ekonomike dhe sociale se sa në retorikë nacionaliste, dhe nuk u përdor gjuhë nxitëse.
- Në përgjithësi është respektuar liria e mediave. Ndonëse raportimi i lajmeve nga fushata kryesisht ishte i balancuar dhe i barabartë, mbulimi i gjerë gjatë kohës me shikueshmëri më të lartë i partive politike përmes hapësirës së sponzoruar e cila nuk është e rregulluar (përveç spoteve politike reklamuese që janë të rregulluara) ka zvogëluar balancën në mbulueshmëri. Kanalet televizive e shfrytëzuan zbrazetinë ligjore për të aplikuar çmime të “negociushme” për mbulimin e sponzoruar, gjë që e dëmton barazinë e garuesve të paraparë me ligj.
- Fushata *de facto* në media filloi shumë para periudhës zyrtare, ku bën fushatë të gjashtë partitë parlamentare shqiptare të Kosovës dhe PDK-ja ka pasur më shumë hapësirë të mbulimit gjatë 20 ditëve para fillimit zyrtar të fushatës në televizionin publik RTK1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) po ashtu ka lëshuar pesë vërejtje për publikim të spoteve reklamuese politike apo programeve të sponzoruara para fillimit zyrtar të fushatës.
- Komuniteti serb ka hyrë në procesin zgjedhor i pakënaqur për shkak të skadimit të aranzhimeve të përkohshme për sistemin e ulëseve ‘të rezervuara’ dhe përdorimit për herë të parë të sistemit të ulëseve ‘të garantuara’. Pëzullimi i përkohshëm i përgatitjeve për zgjedhje dhe mungesa e fushatës në veri cenoi të drejtën e votuesve për tu informuar. Në jug, të gjitha subjektet politike zhvilluan fushatën lirshëm dhe pa incidente, dhe Lista Serbe ri-filloi aktivitetet e fushatës gjatë tre ditëve të fundit.
- Kriteret e të drejtës për të votuar përmes programit për votim jashtë Kosovës janë gjithëpërfshirëse dhe procedurat e qasjes në të janë qartësuar mirë nga KQZ-ja. Më shumë se 16,000 votues nga 29,754 aplikacione, kanë pasur sukses në aplikim për të votuar dhe rreth 15,000 prej tyre kanë votuar. 206 votues të cilët me sukses janë ankuar ndaj vendimit mbi aplikacionet e tyre, mund të mos kenë pasur mundësi të votojnë për shkak kohës së shkurtër për votim jashtë Kosovës. Për më tepër, ankuesit e pasuksesshëm nuk kanë pasur kohë të kërkojnë mjetin e fundit juridik para ditës së zgjedhjeve.

Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM) është i pranishëm në Kosovë nga data 20 maj 2014 me ftesën e Presidentes së Kosovës të datës 8 maj. Misioni udhëhiqet nga Kryesuesi i Vëzhguesve, Roberto Gualtieri, Deputet në Parlamentin Evropian. EU EOM ka shpërndarë gjithsejtë 96 vëzhgues nga 26 shtete anëtare të BE, Norvegjia dhe Zvicra në tërë Kosovën për të vlerësuar tërë procesin zgjedhor në pajtim me obligimet dhe zotimet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe me ligjet e Kosovës. Njëzet e gjashtë vëzhgues nga përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare të BE-së, Norvegjisë dhe Zvicrës, si dhe nga Zyra e BE/PSBE-së po ashtu iu bashkuan misionit në ditën e

zgjedhjeve. [Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit kanë vizituar 510 vendvotime në 353 qendra të votimit për të vëzhguar votimin dhe numërimin.]

Kjo deklaratë preliminare publikohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve pjesërisht do të varet nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, e veçanërisht nga llogaritja e rezultateve dhe shqyrtimi i parashtresave dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. EU EOM do të qëndrojë në Kosovë për të vëzhguar zhvillimet pas zgjedhjeve dhe raportin përfundimtar, i cili do të përfshijë rekomandimet e detajuara, do ta shpallë brenda dy muajsh nga përmbyllja e procesit zgjedhor.

EU EOM është i pavarur në konstatimet dhe konkludimet e tij dhe mbështetet në Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të nënshkruar në selinë e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 2005.

Gjetjet preliminare

Informacione të përgjithshme

Zgjedhjet e parakohshme të vitit 2014 për Kuvendin e Kosovës janë zgjedhjet e dyta parlamentare që mbahen pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, dhe zgjedhjet e para parlamentare që mbahen në tërë territorin sipas ligjeve të Kosovës, pas Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve Beograd-Prishtinë.

Meqë ka pasur pretendime për parregullsi të shumta gjatë zgjedhjeve të vitit 2010 për Kuvendin e Kosovës, të cilat për herë të parë ishin organizuar nga institucionet e Kosovës, zgjedhjet e vitit 2014 janë një test i besueshmërisë me rëndësi të veçantë. Zgjedhjet e parakohshme erdhën si rezultat i votimit për shpërndarjen e Kuvendit, i cili i dha fund një serie të situatave të pakapërcyeshme.

Votuesit u ftuan që të zgjedhin deputetët për 120 ulëset e Kuvendit të Kosovës, 10 prej të cilave janë të garantuara për serbët dhe 10 për përfaqësuesit e tjerë jo-shumicë. Në mesin e 30 subjekteve politike të certifikuara për të marrë pjesë në këto zgjedhje, nëntë ishin subjekte shqiptare të Kosovës dhe 21 i përfaqësonin komunitetet jo-shumicë.

Korniza ligjore

Korniza ligjore ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në Kushtetutën e saj. Kushtetuta e Kosovës e thekson zbatimin e drejtpërdrejtë të disa marrëveshjeve dhe dokumenteve ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Që nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010 janë bërë dy përpjekje të pasuksesshme për reformim gjithëpërfshirës të sistemit zgjedhor dhe për adresimin e të metave të identifikuara në të kaluarën. Megjithatë, legjislacioni që rregullon zgjedhjet në përgjithësi mbetet i pandryshuar. Me ndryshimet e Kodit Penal në vitin 2012 është shtuar numri i veprave penale që lidhen me

zgjedhjet dhe janë përcaktuar dënime më të ashpra me qëllim të parandalimit të shkeljeve zgjedhore.

Disa nga të metat në ligj të identifikuar nga EU EOM janë: mundësia e shkurtimeve të afateve në kuadër të kalendarit zgjedhor, duke përfshirë periudhën e fushatës; mosqartësimi lidhur me atë se si duhet të bëhet ndarja e ulëseve *vis a vis* sistemit të garancisë për subjektet politike jo-shumicë; vet rregulla e përgjithshme e përfaqësimit etnik në organet menaxhuese të zgjedhjeve; mungesa e garancive në ligj për të siguruar mundësinë e barabartë të subjektet politike në hapësirë transmetuese në media; dhe kufizimet e paqarta të kompetencave të KQZ-së dhe PZAP-së me rastin e urdhërimit të ri-numërimit apo përsëritjes së zgjedhjeve.

Sipas ligjit, zgjedhjet duhet të mbahen brenda 30 dhe 45 ditësh nga dita e shpërndarjes së Kuvendit. Presidentja e Kosovës ka vendosur të shpallë zgjedhjet brenda 30 ditësh, duke e bërë të domosdoshëm shkurtimeve të afateve në kalendarin zgjedhor. Ndonëse është e ligjshme, kjo ka paraqitur sfida shtesë për organizimin me kohë të zgjedhjeve dhe për afatet ligjore për parashtrësia dhe ankesa para ditës së zgjedhjeve. Kjo po ashtu ka shkurtimeve fushatën zyrtare në dhjetë ditë.

Kosova konsiderohet si një zonë e vetme zgjedhore me 120 deputetë të zgjedhur drejtpërdrejtë në bazë të listës së hapur. Shpërndarja e ulëseve bëhet sipas përfaqësimit proporcional në pajtim me metodën *Sainte-Laguë*.

Në pajtim me Kushtetutën, sistemi i ulëseve të 'rezervuara' për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë (i përdorur si masë kalimtare për dy legjislacionet e kaluara) është zëvendësuar me një sistem të përhershëm të ndarjes së 20 ulëseve të 'garantuara'. Dhjetë ulëse janë të garantuara për serbët e Kosovës dhe të tjerat për komunitetin boshnjak, turk, goran, rom, ashkali dhe egjiptian. Për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë, sipas ligjit, nuk aplikohet pragu prej 5%.

Përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në organet menaxhuese të zgjedhjeve (KKZ dhe KVV) nuk është i garantuar me ligj, i cili përmban vetëm një rregull të përgjithshme që përcakton se KQZ do të përpiqet të sigurojë që të gjitha komunitetet etnike me numër domethënës në komunat përkatëse të jenë të përfaqësuara drejtë si anëtarë të KKZ-ve. Pastaj, KVV-të duhet të pasqyrojnë përbërjen e KKZ-ve.

Ligji parasheh që së paku 30% e kandidatëve në listën e çdo subjekti politik dhe së paku 30% e të gjitha ulëseve në Kuvendin e Kosovës të jenë për gjininë e përfaqësuar më pak. Kjo dispozitë, është e rëndësishme për të siguruar përfaqësimin e grave por nuk është krejtësisht në pajtim me sistemin e listave të hapura, ku votuesit mund të shprehin preferencën e tyre për kandidatët.

Administrimi i zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organ i përhershëm i përbërë nga anëtarë që përfaqësojnë gjashtë grupet më të mëdha parlamentare të Kuvendit dhe katër grupet jo-shumicë. Ai ka caktuar 38 komisione komunale zgjedhore (KKZ) dhe 2,374 komisione të vendvotimeve

(KVV) në mënyrë specifike për këto zgjedhje. Ai është organi i vetëm me kompetenca vendim-marrëse për të gjitha aspektet e zgjedhjeve dhe KKZ-të i zbatojnë udhëzimet e tij.

Të gjitha nivelet e administrimit të zgjedhjeve e kryejnë punën e tyre në mënyrë transparente, me takime të hapura dhe duke u shpërndarë informacione palëve të interesuara dhe qytetarëve. Një numër i madh vëzhguesish vendorë dhe vëzhguesish të partive politike janë akredituar pa ndonjë pengesë të madhe. Megjithatë, faqja e internetit e KQZ-së nuk është përditësuar gjithmonë me kohë dhe në disa raste përkthimet janë vënë në dispozicion shumë ngadalë.

Përkundër periudhës së shkurtër kohore, administrata e zgjedhjeve i ka organizuar mirë zgjedhjet në nivelin teknik, duke ju përmbajtur shumicës së afateve të saj operacionale, përfshirë edhe trajnimin e KVV-ve, shtypjen e manualeve dhe fletëvotimeve, dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore. KQZ-ja ka organizuar një fushatë të gjerë për edukimin e votuesve, përfshirë edhe votuesit jashtë Kosovës. Komunikimi në mes të KQZ-së dhe KKZ-ve funksionon mirë, me përjashtim të atyre të komunave veriore, ku komunikimet nuk bëhen gjithmonë me kohë.

Herë pas here, vonesat në vendimmarrje dhe veprimet e KQZ-së nuk e kanë rritur besimin e qytetarëve në punën e tij. Përkundër diskutimeve të shumta mbi procedurën për ndarjen e ulëseve në Kuvend, formula e saktë është vënë në dispozicion vetëm disa ditë para ditës së zgjedhjeve. Një vendim i KQZ-së i nxjerr pak para fillimit zyrtar të fushatës për ndalimin e përdorimit të posterëve të caktuar ka qenë pakohshëm, duke shkaktuar pengesa të panevojshme për partitë në fushatë dhe në fund ky vendim është anuluar nga PZAP. KQZ-ja po ashtu ka themeluar një grup punues për të shqyrtuar propozimin për të vendosur para ditës së zgjedhjeve që të bëhet rinumërimi i plotë i votave të të gjitha vendvotimeve në qendrën kryesore të numërimit. Kjo tregon një mungesë besimi në KVV dhe do të kishte qenë në kundërshtim me ligjin.

Roli i OSBE-së në katër komunat veriore ishte ai i dhënies së udhëzimeve për KKZ-të; ndihmës në transportimin e aplikacioneve të votimit përmes postës dhe, nëse ishte e nevojshme, në bashkëpunim me KQZ-në; ndihmës në transportimin e materialeve zgjedhore; dhe këshillim dhe ndihmë teknike për KVV-të.

Regjistrimi i votuesve

Lista përfundimtare e votuesve, e cila bazohet në regjistrin civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përfshinte 1,782,454 votues. Kriteret për të drejtën e votimit janë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë të gjithë votuesit potencialë të cilët kanë të drejtë në shtetësi, por që për shkak të lëvizjes së popullatës në dekadat e fundit mund të mos jenë zyrtarisht qytetarë të Kosovës.

Përkundër pastrimit të fundit të regjistrit civil, ku u larguan rreth 20,000 persona të vdekur, besimi në saktësinë e listës së votuesve mbetet i ultë. Shqetësimi kryesor i subjekteve politike është numri i vlerësuar prej 500,000 personash që nuk jetojnë në Kosovë të cilët ende janë të regjistruar në regjistrin civil dhe në listën e votuesve.

EOM ka vërejtur se listat preliminare të votuesve nuk ishin gjithmonë në dispozicion për konsultim publik gjatë periudhës së kontestimit, siç parashihet me ligj. Kjo periudhë u zgjat nga një në tri ditë por asnjë votues nuk e kontestoi listën për të kundërshtuar pasaktësitë apo lëshimet.

Votimi jashtë Kosovës

Votuesit që jetojnë jashtë Kosovës mund të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare përmes programit për votim jashtë Kosovës. Kriteret për të drejtën e votimit janë gjithëpërfshirëse dhe udhëzimet e dhëna nga KQZ-ja janë të hollësishme dhe të përkthyer saktë. Sidoqoftë, periudha për aplikim zgjati vetëm një javë. Aplikuesit është dashur të paraqesin dokumente që dëshmonin identitetin e tyre bashkë me dokumentet që dëshmonin lidhjen e tyre me Kosovën, në pajtim me ligjin. Pa këto, aplikacioni nuk mund të pranohet. Aplikuesit e suksesshëm gjatë zgjedhjeve të kaluara nuk kanë pasur nevojë të ri-aplikojnë por duhej të kërkonin pakon e votimit.

KQZ-ja ka pranuar 29,754 aplikacione (87% e tyre nga Serbia) dhe gjithsejtë 16,569 janë pranuar në shkallën e parë nga KQZ-ja; këta u përfshinë në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe i morën me kohë fletëvotimet. Prej atyre që janë refuzuar, 9,172 janë ankuar në PZAP, i cili i pranoi vetëm 206. Sipas këtyre dy institucioneve, një numër i madh i aplikuesve/ankuesve nuk i kishin bashkëngjitur dokumentet e nevojshme për të dëshmuar të drejtën e tyre për të votuar, siç parashihet me ligj². Ankuesit e suksesshëm u përfshinë në listën e votuesve jashtë Kosovës, por nuk është e sigurt nëse ata patën mundësi të votojnë³ para afatit të 6 qershorit. Për më tepër, ankuesit e pasuksesshëm nuk patën kohë të ankohen në Gjykatën Supreme. Si pasojë, është cenuar e drejta e tyre për të kërkuar mjetin e fundit juridik. Edhe një herë afati shumë i shkurtër kohor që ishte si rrjedhojë e shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme, ndikoi në të drejtën për të votuar.

KQZ-ja pranoi 15,000 zarfe përmes sistemit postar dhe transportit të ofruar nga OSBE nga Serbia. Numërimi i këtyre votave është duke u bërë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).

Regjistrimi i kandidatëve/ partive politike (listave)

Regjistrimi i kandidatëve është bërë në mënyrë gjithëpërfshirëse. Çdo person në listën e votuesve ka të drejtë që të jetë kandidat. Partitë e regjistruara politike certifikohen në mënyrë automatike përveç nëse e shprehin vullnetin e tyre që të mos marrin pjesë në zgjedhje. KQZ certifikoi 30 subjekte politike: 18 parti politike, shtatë iniciativa qytetare, katër koalicione dhe një kandidat të pavarur. Në kohën e regjistrimit dhe certifikimit, subjektet politike e kanë mundësinë që të deklarohen se e përfaqësojnë njërin prej komuniteteve jo-shumicë. Në mesin e subjekteve politike të certifikuar ishin 21 që përfaqësonin komunitetet jo-shumicë: pesë që përfaqësonin serbët, gjashtë boshnjakët, dy turqit, dy romët, dy ashkalitë dhe dy egjiptianët

Ambienti i fushatës

Aktivitetet e fushatës u vërejtën që nga momenti kur u shpallën zgjedhjet, me përjashtim të veriut. Megjithatë, fushata zyrtare filloi vetëm dhjetë ditë para ditës së zgjedhjeve. Garuesit

² E drejta për të votuar parashihet në nenin 25 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike të 23 marsit 1976.

³ E drejta e mjetit juridik parashihet në nenin 2.3 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike të 23 marsit 1976.

kishin mundësi që të zhvillonin fushatën lirisht dhe fushata u intensifikua në ditët e fundit të saj. Shumica e partive zhvilluan fushatë derë-më-derë dhe takime të vogla, përveç shpërndarjes së fletushkave ose kartëvizitave, e subjektet kryesore politike shfrytëzuan edhe billboardet, tubimet e mëdha, por para së gjithash mbulimin me pagesë në kanalet kryesore televizive, e cila u plotësua me një përdorim dinamik të platformave të mediave sociale. Disa subjekte politike i raportuan vëzhguesve të EOM-së se nëpunësit e shërbimit publik ishin udhëzuar që të merrnin pjesë në tubime.

Kandidatët u fokusuan në zhvillim ekonomik, punësim dhe investime. Në pjesën më të madhe të fushatës toni i përgjithshëm ishte i moderuar ndonëse në ditën e fundit disa parti ju kthyen temave nacionaliste. Me shumë pak përjashtime, të gjithë kandidatët pavarësisht se a përfaqësonin shumicën shqiptare apo komunitetet jo-shumicë, ua drejtuan mesazhet e tyre vetëm komuniteteve të tyre dhe në një gjuhë. Partitë politike vazhdojnë të jenë të dominuara nga meshkujt dhe mediat u japin një mbulim shumë më të gjerë kandidatëve [meshkuj].

Në fushatë dominuan partitë kryesore politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës (PDK, LDK, AAK, VV, AKR). Të gjitha partitë kryesore politike opozitare e kritikuan shfrytëzimin e privilegjuar të televizionit publik nga PDK-ja, përfshirë edhe në periudhën para fushatës, e po ashtu ngritën shqetësime për keqpërdorimin e pretenduar të resurseve publike nga ajo.

Skadimi i sistemit të ulëseve të rezervuara dhe përdorimi i sistemit të garantuar ishte burim pakënaqësisë brenda komunitetit serb. Në këtë kontekst, me 28 maj, katër kryetarët e komunave veriore vendosën të pezullojnë aktivitetet zgjedhore dhe kërcënuan me bojkotim të zgjedhjeve duke përmendur vendimin e KQZ-së lidhur me përbërjen e KVV-ve dhe përdorimin e fletëvotimeve me simbole të Kosovës. Me 3 qershor, pas intervenimit të kryeministrit të Serbisë, Lista Serbe filloi të zhvillojë fushatë aktive në jug, pa incidente. Në veri, udhëheqësit e Listës Serbe më në fund u pajtuan që të mos i bojkotojnë zgjedhjet por në veri nuk u bë fushatë. Megjithatë, pezullimi i aktiviteteve zgjedhore ndikoi në të drejtën për të bërë fushatë dhe të drejtën e votuesve për tu informuar.

Mediat

Liria e mediave në përgjithësi është respektuar dhe mediat patën një mbulim të gjerë të fushatës zgjedhore duke u ofruar shikuesve dhe lexuesve lajme, debate dhe intervista të shumta. Nuk është raportuar asnjë incident lidhur me zgjedhjet që përfshinte gazetarët dhe shumica e bashkëbiseduesve nga mediat theksuan se ndjeheshin të lirë të kryenin punën e tyre. Mediat u përmbajtën nga mesazhet nxitëse edhe pse shumica e tyre e kufizuan raportimin e tyre vetëm për komunitetin e tyre. Debate në mes të anëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike pothuaj nuk pati fare.

Fushata *de facto* në media filloi para periudhës zyrtare. Pesë kanale televizive morën vërejtje nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), organ kushtetues që mbikëqyr transmetimin e aktiviteteve, ku akuzoheshin se kishin transmetuar spote ose programe të sponsoruara nga partitë politike para 28 majit, praktikë kjo që paraqiste shkelje të një rregulloreje specifike të KPM-së⁴. Opozita në masë të madhe u ankua për trajtim të pabarabartë nga televizioni publik RTK gjatë

⁴ Udhëzues i Komisionit të Pavarur të Mediave 2013/03, Neni 2 dhe 22.

periudhës parazgjedhore dhe për mbulimin e gjerë që ky kanal i kishte bërë aktiviteteve të kryeministrit Hashim Thaçi. Analiza e EU EOM-së për periudhën para-fushatës konstatoi se që të gjashtë partitë kryesore shqiptare në Kosovë ishin mbuluar në edicionet e lajmeve të mbrëmjes në RTK, edhe pse PDK-së i ishte dhënë më shumë hapësirë⁵.

Ndonëse ligji e rregullon blerjen e hapësirës së transmetimit të spoteve reklamuese politike, ai nuk e kufizon mbulimin e sponzoruar të aktiviteteve të fushatës. Gjatë fushatës zyrtare mbulimi i sponzoruar në TV u përdor si mjet i fushatës në një nivel i cili, siç thanë të gjithë bashkëbiseduesit, nuk ishte parë në zgjedhjet e mëparshme. Kanalet televizive e shfrytëzuan zbrazëtitë ligjore për të aplikuar çmime të ‘negociushme’ për mbulimin e sponzoruar, praktikë e cila duket se nuk është në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton trajtim të barabartë të garuesve politikë.

Në programet e veta të lajmeve dhe gjatë fushatës, televizioni publik RTK1 pati një mbulim më të madh të kandidatëve të PDK-së dhe LDK-së.⁶ Katër subjekte të tjera parlamentare shqiptare (AKR, AAK, Vetëvendosje dhe Nisma) po ashtu u mbuluan në masë të madhe. Lista Serbe u mbulua më shumë se sa kundërshtari i saj kryesor PDS në programet e lajmeve të kanalit televiziv publik në gjuhën serbe RTK 2.

Mbulimi nga televizionet private TV21 dhe Klan Kosova ishte i balancuar, edhe pse ky i fundit i dha më pak hapësirë AKR-së dhe Nisma-s. Mediat private të Grupit Koha (kanali televiziv KTV dhe gazeta Koha Ditore) patën një qëndrim të qartë negativ ndaj PDK-së. Gazeta Kosova Sot tregoi një qasje shumë të ngjashme ndaj LDK-së. Gazeta Tribuna i dha AKR-së pothuaj të njëjtën hapësirë sa të dytës dhe të tretës, PDK-së respektivisht LDK-së, së bashku. Raportimi nga gazeta Zëri duket të jetë më i balancuari ku shumica e mbulueshmërisë ishte për PDK-në, LDK-në dhe Vetëvendosjen.

Mbulimi i kandidateve [femra] në media ishte shumë i ulët, edhe pse televizioni KTV dhe Radio Kosova u përkujdesen për një pjesëmarrje të gjerë të kandidateve [femrave] në debate.

Shoqëria civile dhe vëzhguesit vendorë

Demokracia në Veprim (DnV), koalicioni i organizatave të shoqërisë civile, është grupi kryesor i vëzhguesve vendor. Ajo ka vëzhguar fushatën dhe përgatitjet për zgjedhje me 100 vëzhgues afatgjatë dhe ka shpërndarë vëzhgues në çdo vendvotim gjatë ditës së zgjedhjeve si dhe ka publikuar disa raporte gjatë periudhës së fushatës.

Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit e EOM-së panë të paktën një vëzhgues vendor të pranishëm në 91 % të vendvotimeve 31 % e të cilëve ishin femra. EOM vlerësoi se ata e kuptonin procesin mirë ose shumë mirë. DnV ishte organizata më e pranishme, e cila u pa e pranishme në 82 % të vendvotimeve.

⁵ PDK 34%, LDK 21%, AAK 15%, Vetëvendosje 13%, AKR 9%, Nisma 6%. Të dhënat për të gjitha partitë politike dhe udhëheqësit e tyre të transmetuara në të gjitha edicionet e “Lajmeve” (lajmet e orës 19:30) prej 8 deri më 27 maj.

⁶ PDK 25%, LDK 21%, AAK 14%, Vetëvendosje 13%, AKR 13%, NPK 10%, PF 3%.

Kontestet zgjedhore

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është organ i pavarur i përbërë nga gjyqtarët i cili është përgjegjës për të vendosur për ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të procesit zgjedhor dhe për ankesat kundër vendimeve të KQZ-së. Paneli ka pranuar gjithsejtë 91 ankesa dhe parashtresa gjatë periudhës së para-fushatës dhe fushatës. Ankesat lidhur me subjektet politike që kishin filluar fushatën para periudhës zyrtare të fushatës u hodhën poshtë si të pabazuara, pasi që ligji nuk e rregullon atë periudhë, e as nuk e ndalon zhvillimin e fushatës.

Votimi dhe numërimi

EU EOM ka vëzhguar hapjen, votimin dhe mbylljen në 510 vendvotime në 37 komuna. Kjo përfaqëson 21.5 % të numrit të përgjithshëm të vendvotimeve në Kosovë⁷.

Në përgjithësi është respektuar ora e hapjes dhe EOM ka vlerësuar pozitivisht procesin e përgjithshëm të hapjes dhe të gjitha procedurat në masë të madhe janë respektuar. Stafii në qendra të votimeve është vlerësuar si profesional. Komisionet e Vendvotimeve (KVV) kanë qenë rregullisht të pranishëm dhe vëzhguesit e EOM-së kanë vlerësuar performancën e tyre si “shumë të mirë” dhe “të mirë” në 95.3 % të rasteve. 17.6 % e anëtarëve të KVV-ve ishin femra por shumë pak prej tyre ishin kryesuese. Vëzhguesit e akredituar që përfaqësonin subjektet politike ishin të pranishëm në shumicën e vendvotimeve. 17 % e tyre ishin femra. Partia më e përfaqësuar ishte LDK-ja, e pranishme në 80 % të vendvotimeve, e pasuar nga PDK-ja me 78 % dhe Vetëvendosja me 77%. Vëzhguesit e BE-së kanë raportuar se qëndrimi i tyre në përgjithësi ka qenë shumë profesional.

Në të gjitha vendvotimet e vëzhguara votimi është zhvilluar në mënyrë pozitive. EU EOM e ka vlerësuar atë si “shumë të mirë” ose “të mirë” në pothuaj shumicën e rasteve; transparenca e procesit po ashtu është konsideruar si “shumë e mirë” ose e mirë”. Vëzhguesit e EOM-së patën mundësi të vëzhgonin operacionin e votimit pa pengesa ose kufizime. Fshehtësia e votës ishte e garantuar në 93% të vendvotimeve të vëzhguara. Megjithatë vëzhguesit vërejtën votues që votonin së bashku në kabinën e votimit në 23% të vendvotimeve.

Procedurat për të siguruar integritetin e votës kryesisht janë respektuar. Megjithatë, stafi në vendvotime nuk e ka bërë kontrollin për gjurmë të ngjyrës në 5% rasteve dhe verifikimi i dokumentit të identifikimit të votuesit nuk është bërë në 4% të rasteve. Struktura e organizimit të votimit në përgjithësi ishte adekuate për mbajtjen e votimit dhe për mbrojtjen e fshehtësisë së votës. EU EOM po ashtu vëzhgoi zhvillimin e votimit me kusht në disa komuna dhe konstatoi se procedurat në masë të madhe ishin respektuar.

Numërimi në përgjithësi u vlerësua pozitivisht në vendvotimet e vëzhguara dhe u zhvillua në mënyrë transparente. Sipas vëzhguesve, synimi i votuesve, kur ishte i qartë, në përgjithësi ishte respektuar sipas standardeve ndërkombëtare dhe legjisllacionit të Kosovës. Megjithatë KVV-të

⁷ Dizajni i metodës së anketimit për fazën e votimit është mostër shtresave të popullsisë e zgjedhur sipas rastit. Madhësia e mostrës përfshinë 277 qendra të votimit, që përfshinë shtresat e popullsisë në 37 prej 38 komunave, për arsye të sigurisë vëzhgimet nuk janë bërë në Zubin Potok. Me nivel të besueshmërisë prej 95 % dhe me interval të besueshmërisë 95 % margjina e gabimit është 2.4 %

nganjëherë kishin vështirësi në plotësimin e formularëve për përputhjen e rezultateve (FPR) dhe në llogaritjen e preferencave për kandidatët. Kjo e ka vonuar shumë finalizimin e numërimit.

Pas numërimit, vëzhguesit e EU EOM-së e përcollën transportimin e materialit zgjedhor deri në KKZ-të përkatëse dhe fazën e pranim-dorëzimit të materialit në 28 KKZ. Misioni thekson se integriteti dhe transparenca e operacioneve janë garantuar në të gjitha KKZ-të e vëzhguara. Tani EU EOM është duke përcjell procesin e verifikimit të votimit jashtë Kosovës në KQZ dhe fazën e pranim-dorëzimit të materialit në QNR. Në ditët në vazhdim, EU EOM do të vëzhgojë fazën e nxjerrjes së rezultateve në QNR në Prishtinë.

Disa raste të izoluara të veprimeve të palejueshme i janë raportuar EOM-së e të cilat janë adresuar nga autoritetet përkatëse.

Kjo Deklaratë preliminare është lëshuar para përfundimit të llogaritjes së rezultateve, shqyrtimit të kontesteve të mundshme pas zgjedhjeve dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare. EU EOM do të publikojë raportin përfundimtar pas përfundimit të procesit zgjedhor. Raporti përfundimtar do të përfshijë rekomandimet e mundshme për përmirësimin e zgjedhjeve të ardhshme.

Një version elektronik i Deklaratës preliminare mund të merret në faqen e internetit të Misionit (www.eueom.eu/kosovo2014). Për më shumë informata, ju lutem kontaktoni me:
Sarah Crozier, Zyrtare e EU EOM për Media, Tel.+386 49 761 007,
sarah.crozier@eueomkosovo2014.eu

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
Hoteli Swiss Diamond, Prishtinë
